



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
- Kuvendi i Komunës-

01.Nr.05-400-1413/12
Kaçanik, 31.01.2012

Në bazë të 40.2(b) të Ligjit nr. 03/L-40-Për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-079.- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, të pikës 5 të Vendimit 01-Nr.400-12114/11.- Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2012 dhe vlerësimet për vitet 2013-2014 si dhe nenit 34.5 dhe 61.1 të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më 31.01.2012, mori këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E BILANCEVE TË PASHPENZUARA NGA TË HYRAT VETJAKE KOMUNALE TË VITIT 2010 DHE 2011, NË VITIN FISKAL 2012

1. Me këtë Vendim, miratohet bartja e mjeteve prej bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetijake komunale të vitit 2010 dhe 2011, në buxhetin e vitit fiskal 2012, në shumë të përgjithshme: **120.322,93 €.**

2. Bilancet e pashpenzuara nga të hyrat vetijake komunale sipas pikës 1. të këtij vendimi dhe pasqyrës tabelare – **Shtojca A**, do të barten në ndarjet buxhetore të vitit 2012, duke u bërë rindarja e tyre në programet – nënprogramet buxhetore dhe në kategoritë e caktuara ekonomike të shpenzimeve, ashtu siç prezantohen në tabelarin – **Shtojca B**, të cilat shtojca janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Rindarja e mjeteve të bartura nga bilancet e pashpenzuara nga viti 2010 dhe 2011, në vitin vijues fiskal 2012, me prioritet do të destinohen për realizimin e projekteve të pa përmbaresha dhe obligimeve - faturave të vonuara dhe të papaguara e të cilat barten në vitin 2012, duke mos u ndryshuar shuma dhe ndarjet e planifikuara me buxhetin e përmbyllur të vitit paraprak 2011. sipas **Shtojcës B** – Rindarja e mjeteve të bartura në vitin 2012.

4. Për realizimin e këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

5. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkiva.

Kryesues i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi
